





# EDUKIMI MJEDISOR



Dhjetor 2025

Edukimi mjedisor i ndihmon nxënësit të njihen me çështje të rëndësishme dhe jetike si: ujin, ajrin, tokën, natyrën, biodiversitetin. Ai është veprimtaria akademike dhe praktike, që përfshinëstudimin sistematik të mjedisit dhe gjithë marrëdhënieve që e shoqërojnë; përmes vëzhgimevedhe eksperimenteve. Përgjatë tyre nxënësit përfshihen emocionalisht dhe fizikisht; ata mësojnëpër zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të ndotjes, mbetjeve, energjisë, ekonomisëqarkulluese. Nxënësit përfshihen në mbrojtjen e natyrës dhe njëkohësisht e duan edhe më shumëatë.

"Edukimi mjedisor rrit njohuritë, aftësitë dhe ndërgjegjësimin për mjedisin, duke nxiturvendimmarrje dhe veprime të përgjegjshme."

UNESCO

Mentorët e tyre, të cilët janë specialistët e edukimit mjedisor në të 12 AdZM-të e venditmbështesin, përfshijnë dhe ndërmarrin nisma të përbashkëta me nxënësit, për përmirësimin e mjedisve të ndryshme. Në sajë të këtyre veprimtarive ata zhvillojnë shprehi dhe dije mjedisore, që i bëjnë të veprojnë në mënyrë të përgjegjshme e të mençur. Përmes edukimit mjedisornxënësit e niveleve të ndryshme akademike përfitojnë:

vetëdije dhe ndërgjegjësim për mjedisin dhe sfidat mjedisore

kuptojnë dhe analizojnë probleme dhe çështje shqetësuese mjedisore

motivohen dhe përfshihen për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në nivel lokal dhe kombëtar

ndërmarrin nisma dhe veprimtari që synojnë mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit



Përmes këtij manuali mujor Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura paraqet aktivitetet e zhvilluara nga 12 Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura, me nxënësit e shkollave tëndryshme në mbarë vendin dhe atyre që ndodhen pranë ZM-ve apo në zonat rurale, përgjatëmuajit dhjetor 2025.

Aktivitetet janë zhvilluar në kuadër të ditëve mjedisore, promovimit të zonave të mbrojtura, lojërave të ndryshme edukative dhe argëtuese në mjediset e shkollave apo në natyrë, duke synuar gjithëpërfshirjen e nxënësve të të dy gjinive, niveleve të ndryshme ekonomike dhe vendndodhjenjeografike.

Nxënës të përfshirë 706

Specialistë të angazhuar 24

Orë mjedisore të realizuara 33

33 Shkolla të përfshira

33 Mësues të përfshirë



# “EDUKIMI MJEDISOR”, SHKODËR



## 10 dhjetor 2025, orë e hapur mjedisore

Specialistët e AdZM Shkodër, në bashkëpunim me nxënësit dhe mësuesit e Shkollës së MesmePyjore “Kolë Margjini”, zhvilluan një aksion sensibilizues pastrimi në zonën e Vilunit, pjesë e Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur “Lumi Buna – Velipojë”.

Gjatë aktivitetit, nxënësit u angazhuan drejtpërdrejt në pastrimin e zonës dhe u njohën me rëndësinë e ruajtjes së mjedisit, duke përcjellë mesazhin se kontributi i përbashkët është thelbësor për një natyrë të pastër dhe të qëndrueshme.

## 11 dhjetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Maleve, specialistët e AdZM Shkodër zhvilluan një orëmjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar Fushë Arrëz, e fokusuar në vlerat natyrore të Malit të Munellës, pjesë e Parkut Natyror të Munellës. Diskutimet u përqendruan në rëndësinë e maleve për biodiversitetin, burimet natyrore dhe rolin e tyre në ruajtjen e ekuilibrave ekologjikë.

Mali i Munellës      sensibilizim  
edukim mjedisor      peisazh i mbrojtur

## 12 dhjetor 2025, orë mjedisore

Në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare "Gjergj Vat Martini" në Velipojë, specialistët e AdZMShkodër organizuan një orë mjedisore pranë Peizazhit Ujor Tokësor të Mbrojtur "Lumi Buna – Velipojë", ku nxënësit u përfshinë në mënyrë aktive në procesin mësimor.


Prezantimet vizuale, materialet edukative dhe krijimtaria artistike e nxënësve ndihmuan nëkuptimin e biodiversitetit të zonës dhe nevojës për mbrojtjen e tij.

## 18 dhjetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Shkodër realizuan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Pjetër Arbërori" në Fushë Arrëz, kushtuar Rrëqebullit të Ballkanit, një nga speciet më të rralladhe më të rrezikuara në vendin tonë.

Përmes dialogut, materialeve informuese dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese, nxënësit u nxitën të reflektojnë mbi rolin e tyre në ruajtjen e biodiversitetit.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, GJIROKASTËR



## 5 dhjetor 2025, kafshë të egra

Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Dheut, specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan njëorë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Meleq Gosnishti”. Gjatë kësaj ore, nxënësit u njohën me rëndësinë e dheut si burim jetësor për natyrën dhe njeriun, si dhe me shtresat që e përbëjnë atë. Përmes diskutimeve dhe shpjegimeve të thjeshtuara, aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rolin e dheut në ruajtjen e ekosistemeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

## 17 dhjetor 2025, aktivitet promovues

Me rastin e ditës së krijimit të Parkut Kombëtar “Bredhi i Hotovës – Dangëlli”, specialistët e AdZM Gjirokastrë zhvilluan një aktivitet promovues me nxënësit e shkollave 9-vjeçare “Meleq Gosnishti” dhe “Nonda Bulka”. Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën më nga afër me vlerat natyrore, biodiversitetin dhe rëndësinë e këtij parku kombëtar, duke kuptuar rolin e zonave të mbrojtura në ruajtjen e pasurive natyrore dhe trashëgimisë mjedisore.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, DIBËR



## 10 dhjetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Bashkuar “Gjergj Kastrioti” në Baz.

Përmes vizatimeve dhe punës kreative, nxënësit u njohën me rëndësinë që kanë malet, strukturëne tyre dhe rolin që ato luajnë në zhvillimin e turizmit, ruajtjen e biodiversitetit dhe ekuilibratnatyrorë.

## 12 dhjetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Dibër, në bashkëpunim me Shkollën “Gjergj Kastrioti” Baz, Burrel, zhvilluan një orë mjedisore me temë “Zogjtë në fole”.

Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë e zogjve në ekosisteme dhe rolin e tyre në ruajtjen e biodiversitetit. Përmes punimeve praktike, ata realizuan fole zogjsh, imitime vezëshdhe figura të ndryshme, duke nxitur kreativitetin dhe të mësuarit praktik.

## 19 dhjetor 2025, orë mjedisore

Me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Papa Gjon Pali II” Ulëz, specialistët e AdZM Dibër zhvilluan një orë mjedisore me temë “Krijimtari Festive”.

Nxënësit u angazhuan në realizimin e pemës së Krishtlindjes dhe kurorave festive, duke përdorur elemente krijuese dhe materiale të thjeshta, si dhe duke u nxitur të reflektojnë mbi ripërdorimindhe kujdesin ndaj mjedisit.

Orë mjedisore krijimtari

zogjtë shtegtarë



# “EDUKIMI MJEDISOR”, BERAT



## 5 dhjetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e ADZM Berat zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9 vjeçare “Tomorri”, me fokus mbrojtjen e mjedisit dhe pastrimin e ambjenteve. Nxënësit morën pjesëaktivisht në mbjelljen e fidanëve në oborrin e shkollës, duke reflektuar mbi rëndësinë e kujdesit për tokën dhe natyrën.

ditë botërore zona të mbrojtura

biodiversitet



# “EDUKIMI MJEDISOR”, LEZHË



## 3 dhjetor 2025, Ditës Botërore e Dheut

Në kuadër të kësaj dite, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Fran Ivanaj”.

Gjatë aktivitetit, nxënësit bashkëbiseduan mbi rëndësinë e dheut dhe shtresat që e përbëjnë atë, duke ndarë mendime dhe pyetje me interes. Në përfundim, u realizua edhe një eksperiment ithjeshtë në klasë, i cili ndihmoi në kuptimin praktik të proceseve natyrore që ndodhin në tokë. Aktiviteti synoi rritjen e ndërgjegjësimit të brezave të rinj mbi rolin kyç të tokës në ruajtjen e mjedisit.

## 12 dhjetor 2025, rëndësia e lagunave

Me rastin e Ditës së Lagunës së Patokut, specialistët e AdZM Lezhë zhvilluan një aktivitetmjedisor me nxënësit e të shkollës 9-vjeçare “Nike Tomë Prela” në Gorre. Nxënësit u njohën me vlerat unike natyrore të Lagunës së Patokut, biodiversitetin dhe rëndësinë e ruajtjes së saj. Përmes krijimit të posterave me mesazhe sensibilizuese dhe lojës edukative “Harta me zëra”, fëmijët u përfshinë aktivisht në procesin mësimor, duke kombinuar njohuritë, kreativitetin dhe dashurinë për natyrën.



Laguna e Patokut    zona të mbrojtura

orë mjedisore    shtresat e dheut



# “EDUKIMI MJEDISOR”, DURRËS



## 3 dhjetor 2025, Dita Botërore e Dheut

Në kuadër të Ditës Botërore të Dheut, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Perlat Durrës” në Krujë.

Aktiviteti u fokusua në rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve mbi rëndësinë e dheut dhe rolin e saj në ruajtjen e mjedisit. Gjatë orës, u trajtuan konceptet bazë të mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, ndërsa nxënësit u përfshinë aktivisht në diskutime dhe shkëmbim mendimesh mbi mënyrat konkrete të kontributit në jetën e përditshme.

Një pjesë e aktivitetit iu kushtua realizimit të posterave me mesazhe ndërgjegjësuese, si dhe një aksioni simbolik gjelbërimi në ambientet e shkollës, ku u mbollën 20 fidanë pyjorë. Aktiviteti synoi forcimin e lidhjes së fëmijëve me natyrën dhe nxitjen e përgjegjësisë mjedisore që nëmoshë të hershme.

## 10 dhjetor 2025, orë mjedisore

Në atmosferën festive të fundvitit, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Myrteza Hamit Pengili” në Krujë.

Nxënësit u njohën me Parkun Natyror të Qafështamës, vlerat e tij natyrore dhe rëndësinë e biodiversitetit, si dhe me rolin e maleve në ruajtjen e ekuilibrave natyrorë. Diskutimet u shoqëruan me shembuj praktikë dhe ndërveprim aktiv me nxënësit.

Në kuadër të krijimtarisë festive, fëmijët realizuan bredhin festiv, duke e trajtuar atë si simbol të natyrës së gjallë dhe të nevojës për mbrojtjen e saj. Aktiviteti u përmbyll me mesazhe pozitivë mbi dashurinë dhe kujdesin ndaj mjedisit.

## 11 dhjetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Maleve, specialistët e AdZM Durrës zhvilluan një orëmjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Myrteza Kaçaçi" në Krujë.

Gjatë aktivitetit, nxënësit u njohën me rëndësinë që kanë malet për natyrën dhe jetën e njeriut, rolin e tyre në klimë, burimet ujore dhe biodiversitetin. Diskutimet u fokusuan gjithashtu nënevojën për mbrojtjen e ekosistemeve malore nga ndotja dhe degradimi.

Në vijim, nxënësit u angazhuan në punë krijuese, duke realizuar modele malesh me materiale tëndryshme, çka i ndihmoi të shprehin njohuritë dhe imagjinatën e tyre në mënyrë praktike.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, TIRANË



## 3 dhjetor 2025, Ditës Botërore e Dheut

Specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Shëngjergj” në Parkun Natyror Mali me Gropa–Bizë–Martanesh. Nxënësit mësuhan se toka është burim jetik dhe biodiversiteti, dhe si mund ta mbrojnë atë. Aktiviteti u përmbyll me poster kreativë që transmetojnë mesazhin: kujdesi për tokën është përgjegjësi për të ardhmen!

## 9 dhjetor 2025, aksion pastrimi

Në kuadër të fushatës “Mjedisi është shtëpia jonë”, specialistët e AdZM Tiranë, zhvilluan një aktivitet pastrimi me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Bahri Nela”. Nxënësit u angazhuan në pastrimin e brigjeve përgjatë lumit Tërkuzë, duke demonstruar se edhe veprimet e vogla kanë ndikim të madh në mbrojtjen e mjedisit. Aktiviteti shërbeu si shembull pozitiv për komunitetin dhe si nxitje për përfshirjen aktive të të rinjve në ruajtjen e natyrës.

## 13 dhjetor 2025, orë mjedisore

Në shkollën 9-vjeçare “Hamdi Mancaku”, në fshatin Zall Dajt, pjesë e PKMD, specialistët e AdZM Tiranë zhvilluan orën mjedisore “Mbro jetën e vogël”, në bashkëpunim me një bletërritës lokal.

Nxënësit e klasave VII dhe IX realizuan një vizitë edukuese, ku u njohën nga afër me botën e bletëve, rolin e tyre të pazëvendësueshëm në natyrë dhe procesin e prodhimit të mjaltit. Përmes vëzhgimit dhe bashkëbisedimit, nxënësit u ndërgjegjësuhan mbi rëndësinë e mbrojtjes së bletëve dhe biodiversitetit.

natyrë    park natyror  
orë mjedisore    ditë botërore



## 16 dhjetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Tiranë, së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Tufinë", zhvilluan njëorë mjedisore kushtuar krijimit të dekoreve për festat e fundvitit.

Nxënësit realizuan zbukurime dhe punime artistike duke përdorur materiale natyrore si degë, gjethe dhe fara, si dhe vizatime plot ngjyra që sollën atmosferë festive në klasë. Aktiviteti synoi të nxiste kreativitetin, ripërdorimin e materialeve natyrore dhe dashurinë për mjedisin.



18 dhjetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Elbasan zhvilluan një aktivitet edukues me nxënësit, ku ata u njohën ngaafër me florën dhe faunën e Parkut Kombëtar Shebenik. Nxënësit kuptuan rëndësinë e biodiversitetit dhe rolin e tij në ruajtjen e ekosistemeve natyrore.



ditë botërore    flora dhe fauna  
edukim mjedisor    zona të mbrojtura

# “EDUKIMI MJEDISOR”, FIER



## 1 dhjetor 2025, aksion pastrimi

Specialistët e AdZM Fier , së bashku me grupin rinor “Epoka e Re” – Fier, hodhën hapin e parë për një mjedis më të pastër dhe të gjelbër në zonën e Pishë-Poros. Bashkëpunimi, energjia dhe veprimi konkret e bënë këtë ditë të veçantë për natyrën.

## 9 dhjetor 2025, vizitë studimore

Studentët e programit Master në Shkencat e Mbrojtjes së Mjedisit, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” – Elbasan, zhvilluan një vizitë studimore nën udhëheqjen e specialistëve të AdZM Fier. Ata u njohën me menaxhimin dhe monitorimin e zonave të mbrojtura dhe eksploruan Lagunën e Karavastasë, një nga habitatet më të rëndësishme për shpendët ujore, duke parë nga afër pelikanin kaçurrel, simbol i zonës.

## 11 dhjetor 2025, orë mjedisore

Nxënësit e shkollës Vajkan vizituan parkun dhe u njohën nga afër me zonat e mbrojtura, ekosistemet e lagunës dhe speciet e saj unike. Ata morën njohuri nga specialistët e AdZM Fier mbi biodiversitetin dhe ruajtjen e natyrës, dhe patën mundësinë të shohin nga afër pelikanin kaçurrel, një nga shpendët më të rrallë dhe të mbrojtur.

pasuri natyrore orë mjedisore  
zonë e mbrojtur park kombëtar

## 14 dhjetor 2025, mbjellje pishash

Nxënësit e shkollës 9-vjeçare Vajkan, Fier, morën pjesë në një aktivitet të veçantë mbjelljeje pishash, i organizuar nga specialistët e AdZM Fier. Pas njohjes me vlerat natyrore dhe biodiversitetin e parkut, fëmijët u angazhuan në mbjelljen e pishave, duke kuptuar rëndësinë e kësaj veprimtarie për ruajtjen e natyrës dhe ekosistemeve. Aktiviteti synoi të risëndërgjegjësimin e të rinjve për kujdesin ndaj mjedisit, të forcojë lidhjen e tyre me natyrën dhe të nxisë përgjegjësinë për një të ardhme më të gjelbër.

## 18 dhjetor 2025, markim shtegu

Së bashku me nxënësit e shkollës 9-vjeçare Gërmenj, Divjakë dhe Shoqatën Mjedisore HorizontEU, specialistët e AdZM Fier filluan markimin e Shtegut të Gjenerukës në Parkun Kombëtar Divjakë–Karavasta. Ky shteg do të ndihmojë vizitorët të eksplorojnë natyrën në mënyrë të sigurt dhe të orientuar. Përmes këtij aktiviteti, nxënësit mësuuan si mund të kontribuojnë në mbrojtjen e natyrës dhe të ndihmojnë vizitorët të eksplorojnë parkun në mënyrë të sigurt, të përgjegjshme dhe të respektueshme ndaj ekosistemit.

# “EDUKIMI MJEDISOR”, KUKËS



11 dhjetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Specialistët e AdZM Kukës zhvilluan një orë të hapur mjedisore me nxënësit e Shkollës së Mesme të Bashkuar “Imer Mata” Zapod, në Parkun Natyror “Korab-Koritnik”. Nxënësit sëbashku me mësuesit mbollën 100 fidanë pishë të zezë në oborrin e shkollës, duke kontribuar në rritjen e gjelbërimit dhe krijimin e një mjedisi më të shëndetshëm për komunitetin. Aktiviteti kishte për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e nxënësve mbi rëndësinë e mbrojtjes së natyrës dhe kujdesit për pyjet, pasuri e paçmuar e vendit.

edukim mjedisor    habitate  
ditë botërore    zona të mbrojtura

# “EDUKIMI MJEDISOR”, KORÇË



## 4 dhjetor 2025, orë mjedisore

Specialistët e AdZM Korçë zhvilluan një orë mjedisore me nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, ku ata mësuan procesin e mbjelljes së farave dhe krijuan vazo lulesh. Ky aktivitet përçoimesazhin e kujdesit dhe respektit për natyrën.

## 10 dhjetor 2025, vizitë në Liqenin e Pogradecit

Nxënësit e klasës së 12-të të Shkollës së Mesme “Gjergj Pekmezi” vizituan Peizazhin e Mbrojtur Tokësor Ujor të Liqenit të Pogradecit dhe diskutuan për rëndësinë e kurorës malore përekosistemet dhe bukurinë natyrore të zonës.

edukim mjedisor  
zonatë mbrojtura

mbjellje fidanësh

## 11 dhjetor 2025, Dita Ndërkombëtare e Maleve

Për të shënuar Ditën e Maleve, specialistët e AdZM Korçë zhvilluan aktivitete mjedisore me nxënësit e shkollës "Raif Kolami" dhe shkollës 9-vjeçare "Papa Kristo". Nxënësit e "Raif Kolami" mbollën fidanë bliri dhe bredhi në oborrin e shkollës, duke kontribuar në gjelbërimin e ambientit, ndërsa nxënësit e klasës së pestë të "Papa Kristo" vizatuan malet dhe morën mesazhesensibilizuese mbi rëndësinë e ruajtjes së natyrës dhe ekosistemeve malore.

---

## 16 dhjetor 2025, aksion mbjelljeje

Nxënësit e Shkollës së Mesme "Muharrem Çollaku", nën udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e specialistëve të AdZM Korçë, morën pjesë në një aksion mbjelljeje pranë fshatit Geshtenjas, kumbollën fidane të llojit pishë e zeze dhe qershë e egër. Ky aktivitet nuk ishte vetëm një veprimkonkret për gjelbërimin e zonës dhe përfshirjen në projektin "PMTU-Liqen i Pogradecit", por gjithashtu një mjet i rëndësishëm edukativ për nxënësit, duke i njohur me kulturën e mbjelljes, kujdesin për natyrën dhe përgjegjësinë ndaj ekosistemeve.

## 5 dhjetor 2025

Studentët e degës Teknik Laboratori në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë zhvilluan një orëmjedisore në Qendrën e Trajtimit të Breshkave, nën udhëheqjen e specialistëve të AdZM Vlorë. Gjatë aktivitetit, studentët u njohën me monitorimin e breshkave të detit, një specie kyçe përshëndetin e ekosistemeve detare, dhe kuptuan rëndësinë e zonave të mbrojtura dhe rolin e biodiversitetit. Aktiviteti synoi të rrisë ndërgjegjësimin e të rinjve dhe të përfshijë ata aktivisht në mbrojtjen e natyrës.

